



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 474/1 Prot.

Tiranë, më 06.03.2026

V E N D I M

Nr. 51, datë 06 .03. 2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 64 regj, datë 02.03.2026, të paraqitur nga shtetasi E. M. O. M, kundër Personit Fizik: G. N, me Nipt xxxxxxxxxxx, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të “racës”, “etnisë”, “gjuhës”, “shtetësisë”, “gjendjes ekonomike”, “përkatësisë në një grup të veçantë”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Nëpërmjet ankesës objekt shqyrtimi, Komisioneri informohet se, shtetasi E.M. O.M, me shtetësi egjiptiane me profesion peshkatar, po mbahet i izoluar kundër dëshirës së tij nga punëdhënësi z. G.N, në një banesë private në Orikum, Vlorë.

Bazuar në informacionin e parashtruar në ankesë, pretendohet se punëdhënësi po e pengon fizikisht ankuesin që largohet nga vendi ku po mbahet dhe se punëdhënësi kërkon një pagesë prej 1080 euro në këmbim të lirisë së tij. Pretendohet se ankuesi është duke u shfytëzuar, pasi nga ana e punëdhënësit nuk i është bërë pagesa e pagave dhe është shkelur kontrata e punës e nënshkruar më datë 30.12.2025. Gjithashtu kufizimi i lirisë së lëvizjes dhe detyrimi financiar, janë indikatorë të trafikimit të qenieve njerëzore.

Pala ankuese kërkon nga Komisioneri marrjen e masave urgjente si më poshtë:

- Dërgimin e një njësie policore në adresën/vendbanimin e punëdhënësit për të siguruar lirinë e ankuesit (viktimës);
- Sigurimin e një strehëze të sigurt (Safe House) për viktimën përmes IOM ose organizatave përkatëse;

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

- Nisjen e procedimit penal ndaj punëdhënësit për trafikim të qenieve njerëzore dhe heqje të paligjshme të lirisë sipas Kodit Penal të Shqipërisë.

Referuar përmbajtjes së ankesës së depozituar pranë Komisionerit, konstatohet se i njëjti ankim i është drejtuar Policisë së Shtetit Vlorë, Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Ambasadës së Egjiptit në Tiranë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Sipas nenit 5, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Ankesa nr.64, datë 02.03.2026, me palë ankuese shtetasin E.M.O. M, është paraqitur në emër të këtij të fundit nga ana e shtetasit M. H. Shtetasi M.H, pretendon se është pajisur nga ana e ankuesit E.M.O. M me autorizimin datë 01.03.2026, nëpërmjet të cilit autorizon shtetasin M.H, që ta përfaqësojë, ndër të tjera edhe pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore për lirim e tij të menjëhershëm, pasi është duke u privuar nga liria e lëvizjes dhe është izoluar forcërisht nga punëdhënësi. Autorizimi i datës 01.03.2026, i cili është depozituar bashkëlidhur ankesës, nuk rezulton të jetë nënshkruar nga ankuesi shtetasi E.M.O. M por nga vetë shtetasi M.H.

Nëpërmjet *e-mailit* të datës 04.03.2026, shtetasi M.H paraqiti një kërkesë me shkrim nëpërmjet të cilës kërkon zyrtarisht mbylljen dhe arkivimin e çështjes, pasi falë ndërhyrjes dhe koordinimit nga ana e institucioneve është bërë e mundur që shtetasi E.M.O.M ka udhëtuar sot në mëngjes drejt Egjiptit, duke u përbyllur me sukses procesi i riadhesimit të tij. Falë angazhimit dhe bashkëpunimit nga ana e të gjitha institucioneve u mundësua një zgjidhje e shpejtë e situatës brenda kordinaze ligjore dhe njerëzore.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Në nenin 90, “Përfundimi i procedurës administrative”, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, sanksionohet se: “3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrative.”. Ndërsa, në nenin 94 “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pikat 1 dhe 3, të Kodit të procedurave Administrative, parashikohet si vijon: “1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.3. Në çdo rast, tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës nuk ndikon në vazhdimin e tij, nëse organi publik çmon se vazhdimi i procedurës është në interes publik, me përjashtim të rasteve kur procedura është e tillë që mund të fillojë vetëm me kërkesën e pales.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur në datën 04.03.2026, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës Nr. 64 regj, datë 02.03.2026, e paraqitur nga shtetasi E.M.O.M kundër Personit Fizik: G. N, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a” dhe pika 2, nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenin 90, pika 3 dhe nenin 94, pikat 1 dhe 3, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar pa një vendim përfundimtar, procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.64 Regjistri, datë 02.03.2026, paraqitur nga shtetasi E. M.O.M kundër Personit Fizik: G. N, për shkak se pala ankuuese është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: “raca”, “etnia”, “gjuha”, “shtetësia”, “gjendja ekonomike”, “përkatësia në një grup të veçantë”.
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Tërheqje nga ankesa